

# LEGJISLACIONI PËR SHOQËRI CIVILE

Meqenëse karakteristikë kryesore e sektorit civil është parimi i mos-shpërndarjes së fitimit, korniza ligjore që përcakton parimet rregullative të këtij sektori zakonisht njihet me termin "e drejta e sektorit jo-për-përfitim".

Organizatat e shoqërisë civile veprojnë në pajtueshmëri me rendin juridik dhe kornizën ligjore të aplikueshme në vendin në të cilin ato veprojnë, sikurse edhe me parimet e së drejtës ndërkombëtare. Në nivelin ndërkombëtar, janë disa dokumente që i përcaktojnë parimet kryesore të së drejtës së sektorit jo-për-përfitim, duke filluar nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Rekomandimi CM/Rec(2007)14 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare rreth statusit ligjor të organizatave jo-qeveritare në Europë, etj. Legjislacioni kombëtar duhet të jetë në përputhje me parimet e këtyre dokumenteve ndërkombëtare.

## CILI PËRFSHIHET NË LEGJISLACIONIN PËR SHOQËRI CIVILE NË KOSOVË?

Në Kosovë, liria e asociimit është e garantuar me Kushtetutë. Regjistrimi nuk është i obliguar, edhe pse shumica e organizatave të shoqërisë civile që janë aktive në Kosovë janë të regjistruara si OJQ. Për këtë arsy, korniza ligjore që e prek drejtpërdrejtë këtë sektor kryesisht përfshihet në Ligjin për Liri të Asociimit në OJQ (në praktikë i quajtur “Ligji për OJQ”), i cili rregullon elementet kryesore të themelimit, organizimit, qeverisjes së brendshme dhe shuarjes së OJQ-ve, si dhe elementet kryesore të Statusit për Përfitim Publik. Përveç këtij ligji, punën e përditshme të ndikojnë drejtpërdrejtë edhe ligjet që kanë të bëjnë me çështjet fiskale/tatimore (Ligji për Tatim në të ardhura personale, Ligji për Tatim në të ardhura të Korporatave, Ligji për TVSH), ligjet dhe rregulloret që e përcaktojnë mënyrën e punës së institucioneve me të cilat këto organizata ndërveaprojnë (Rregullora e Punës e Kuvendit të Kosovës, Rregullorja e Punës e Qeverisë, Ligji për Vetqeverisje Lokale dhe Statutet e Komunave, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Nisma Legjislative, etj), si dhe ligjet specifike të fushëveprimtarisë përkatëse të organizatave të ndryshme.

## CILAT ELEMENTE TRAJTOHEN NGA LEGJISLACIONI PËR SHOQËRI CIVILE NË KOSOVË?

**OJQ-të** në Kosovë mund të themelohen si shoqata ose fondacione. **Shoqatat** themelohen për të mbrojtur dhe avancuar interesin e përbashkët të anëtarëve. Shoqatën mund ta themelojnë të paktën tre (3) ose më shumë persona, ku të paktën njëri prej tyre ka vendbanimin ose zyrën në Kosovë. Anëtarë të shoqatës mund të janë qoftë personat fizikë (individët) po ashtu edhe personat juridikë (organizata tjera). **Fondacionet** themelohen gjithashtu për të avancuar një qëllim të caktuar (kryesisht që është në të mirë të publikut të gjërë, por jo patjetër), mirëpo nuk kanë anëtarë. Fondacionet themelohen kur një pasuri/aset i caktuar lihet në shërbim të një çështjeje/qëllimi. **Fondacionin** mund ta themelojë një individ (apo më shumë), me testament ose akt themelues.

### CILAT ELEMENTE TRAJTOHEN NGA E DREJTA JO-PËR-PËRFITIM?

Elementet kryesore që trajtohen nga e drejta e sektorit jo-për-përfitim përfshijnë parimet e përgjithshme të subjektivitetit juridik dhe pavarësisë së veprimit; fushë veprimtaria dhe misioni; themelimi dhe shuarja, rregullimi i brendshëm dhe anëtarësia; menaxhimi; ngritja e fondeve, pronat dhe përkrahja publike; llogaridhënia, transparenca dhe mbikëqyrja; etj.

**Për t'u regjistruar**, themeluesit duhet të dorëzojnë në DRNOJQ kërkesën për regjistrim, aktin e themelimit dhe statutin, si dhe caktojnë një përfaqësues të autorizuar i cili do t'i pranojë të gjitha dokumentet në emër të organizatës. DRNOJQ duhet të lëshojë certifikatën e regjistrimit në një afat prej më së shumti 60 ditësh, përvèç nëse kërkohen dokumente shtesë apo refuzohet me shkrim regjistrimi.

**OJQ-të nuk guxojnë të shpërndajnë të ardhura ose fitime për asnjë person**, përvèç pagesës së arsyeshme për punën që e bëjnë për atë OJQ. **OJQ-ja mund të angazhohet në aktivitete ekonomike**, mirëpo të gjitha pasuritë dhe të ardhurat duhet të përdoren për të mbështetur misionin e organizatës.

**Secila OJQ është e obliguar që çdo vit të dorëzojë në DRNOJQ** një deklaratë që konfirmon se të dhënat bazë të saj nuk kanë ndryshuar, ose që njofton me ndryshimet e atyre të dhënave. Nëse kjo deklaratë nuk dorëzohet për 2 vite me rradhë, OJQ-ja çregjistrohet, pas një njoftimi nga DRNOJQ 60 ditë para skadimit të afatit.

Nëse aktivitetet parësore të OJQ-së janë njëra ose disa nga aktivitetet që konsiderohen përfitim publik, ajo mund të marrë **Statusin përfitim Publik**. Ky status është i përvjetshëm dhe konsiston në lehtësira tatimore dhe obligime për raportim. OJQ-të me Status përfitim Publik çdo vit duhet të dorëzojnë në DRNOJQ raportin për veprimtarinë dhe atë financiar, jo më vonë se më 31 mars të vitit pasues. OJQ-të me Status përfitim Publik me të hyra ose shpenzime vjetore mbi 100,000 EUR duhet ta dorëzojnë edhe raportin e auditimit financiar për vitin paraprak.

**Lirimet tatimore dhe doganore për OJQ** në legjislacionin përkates nuk janë të lidhura patjetër me Statusin përfitim Publik. Kështu, mundësohet lirimi nga tatimi në të ardhura të korporatave, me kush që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime të përfitimit publik (vetëm për OJQ-të me Status të Përfitimit Publik); lirimi nga Tatimi në pronë të paluajtshme, përvèç kur kjo pronë shfrytëzohet për veprimtari komerciale ose krijim të fitimit (vetëm për OJQ-të me Status të Përfitimit Publik); lirimi nga detyrimet e importit për mallra të dërguara falas nga një person apo organizatë e vendosur jashtë Kosovës dhe pa ndonjë qëllim komercial nga ana e dërguesit (vetëm për OJQ-të humanitare dhe bamirëse).

Gjithashtu, lirimi nga tatimi në të ardhura personale dhe të korporatave mundësohet për **subjektet private që kontribuojnë për qëllime** humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, të mbrojtjes së ambientit dhe sportive lejohen si zbritje me vlerë maksimale prej pesë për qind (5%) të të ardhurave të tatushme të llogaritura përpëra se të jetë zbritur ky kontribut, me kusht që pranuesi të jetë OJQ me Status të Përfitimit Publik.

#### **CILAT JANË INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ZBATIM?**

Institucioni përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ është Departamenti pë Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ (DRNOJQ) pranë Ministrisë së Administratës Publike, ndërsa institucionet përgjegjëse për pjesën tatimore dhe doganore janë Administrata Tatimore e Kosovës, respektivisht Doganat e Kosovës.

*Duke njobur faktin që jo vetëm organizatat jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-të) bëjnë pjesë në shoqëri civile, termi OShC u referohet të gjitha formave të organizuara të shoqërisë civile. Termi OJQ, në këtë dokument, përdoret vetëm në rastet kur flitet për dispozitat konkrete ligjore të cilat u referohen konkretisht organizatave jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-ve).*



Qendra ofron si dhe i përgjigjet çdo kërkeze për informacion për nevojat e organizatave të shoqërisë civile (OShC), qytetarëve të interesuar, institucioneve publike dhe organizatave donatore për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

#### **QËLLIMI I QENDRËS:**

- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit
- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes
- Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit rreth sektorit të shoqërisë civile
- Krijimi i instrumenteve për mbledhjen dhe analizën e vazhdueshme të të dhënave për sektorin e shoqërisë civile dhe fusha të veçanta të këtij sektori
- Ngritja e kapaciteve të OShC-ve dhe institucioneve publike për bashkëpunimin ndërsektorial
- Promovimi dhe përkrahja e drejtpërdrejtë në qeverisjen e mirë të brendshme të OShC-ve

#### **ÇKA OFRON QENDRA?**

- **Deskun e informacionit** i cili i përgjigjet çdo kërkeze për informacion rreth sektorit të shoqërisë civile dhe pranon kërkesat e OShC-ve për trajnime, përkrahje dhe mentorim
- **Trajnime bazike dhe të avancuara** për pjesëtarët e OShC-ve, në baza të rregullta ose në bazë paraqitjes së kërkesës nga ana e OShC-ve
- **Shërbimin e këshillimit gjatë punës dhe mentorimit** që ofron këshillim dhe mentorim në punën e përditshme të OShC-ve në bazë të kërkesës së tyre
- **Këndin e informacionit** ku vizitorët mund të marrin informata rreth sektorit të shoqërisë civile dhe broshura e artikuj informues për këtë sektor
- **Këndin e leximit** që mund të presë deri në 10 vizitorë
- **Këndin e bibliotekës** ku vizitorët mund të gjejnë libra dhe artikuj nga fusha e zhvillimit të shoqërisë civile dhe procesit të integrimit europian
- **Sallën e pajisur** me të gjitha elementet me kapacitet deri në 25 persona

**ORARI I PUNËS**  
e hënë – e premtë  
10:00 deri 14:00



**CILAT JANË RREGULLAT PËR VIZITORË?**

Broshurat dhe fletushkat jepen falas për të gjithë vizitorët

Librat, butelinët dhe publikimet tjera mund të lexohen vetëm brenda Qendrës

Të gjithë të interesuarit për shërbimet e Qendrës duhet të kontaktojnë deskun e informacionit, me shkrim apo drejtpërdrejtë